



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

Ballsh më 12.02.2026

NJOFTIM PUBLIK

PËR FSHIRJEN, SHUARJEN DHE PAGESËN E DETYRIMEVE TATIMORE NDAJ ADMINISTRATËS TATIMORE QENDRORE E VENDORE

Në zbatim të ligjit **86/2025** datë 11.12.2025 “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë”, Bashkia Mallakastër njofton subjektet debitore se :

1. **Ligji 86/2025** parashikon kushtet për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore të papaguara ndaj administratës tatimore qendrore dhe administratës tatimore vendore, për kategoritë e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.
2. Përfitimi nga ky ligj zbatohet sipas periudhave kohore të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore të përcaktuara në këtë ligj.

Të gjithë subjektet dhe individët që pretendojnë përfitim nga ligji 86/2025 ,të paraqiten pranë Bashkisë Mallakastër në sportelin me një ndalesë për tu informuar në lidhje me detyrimet që kanë ndaj Bashkisë Mallakastër.